



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I I P R O C E S V E R B A L I T

**të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 22.09.2015,
e cila filloi në orën 15:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha përfaqësuese e LVV-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Munguan: Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së.

Morën pjesë edhe: Agim Salihu, këshilltar i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit, Florina Rrahmani, përfaqësuese nga Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, përfaqësues të mediave dhe përfaqësues nga OSBE-ja.

Mbledhjen e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit.

Para se të fillonin diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Lirak Çelaj** propozoi që të shtohet edhe një pikë lidhur me kërkesën e komunitetit protestant për ndarjen e një parcele për varreza dhe kishën protestante, gjithashtu propozoi që të zvogëlohet numri i pikave të rendit të ditës, të ndahen pikat 4,5,6,7 dhe 8 për mbledhjen e radhës.

Kryesuesi **Halim Halimi**, tha se nëse është dërguar kërkesa për caktimin e lokacionit për varreza dhe kishën protestante në Drejtorinë e Financave dhe Pronës, ajo duhet dërguar në Këshillin e Drejtorëve, pastaj në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Sami Hamiti u shpreh i pajtimit me mendimin e z. Çelaj lidhur me numrin e madh të pikave të rendit të ditës, që ishin 15 pika, e sidomos kur kemi të bëjmë me buxhet. Sa i përket kërkesës së komunitetit protestant, kjo është kërkesë e kahershme, nuk është kërkesë e tashme, andaj e përkrah që të diskutohet. Ai shprehu mendimin se në këtë mbledhje do të duhej të paraqitej procesi i riorganizimit të drejtorive të Komunës dhe raporti i Auditimit të Përgjithshëm.

Qëndron Kastrati, lidhur me ndarjen e lokacionit për kishën protestante, theksoi se jemi të pajtimit, ndërsa u shpreh kundër ndarjes së varrezave në bazë të përkatësisë fetare.

Sa i përket zvogëlimit të numrit të pikave të rendit të ditës, shprehu mendimin se ai nuk duhet ndryshuar, por nëse është e nevojshme, mbledhja të vazhdojë edhe një ditë tjetër.

Hatixhe Hoxha pyeti për mundësinë e futjes si pikë e rendit të ditës, si kërkesë e Grupit të grave, caktimi i një lokacioni për objektin për strehim ditor të personave me aftësi të kufizuara.

Kryesuesi sqaroi se pa u shqyrtuar kërkesa në Drejtorinë e Pronës, nuk mundë të futet në rend të ditës për KPF.

Lirak Çelaj u shpreh kundër ndarjes së varrezave në bazë të përkatësisë fetare. Në varrezat e Prishtinës ekziston vetëm një xhami, por duhet të jetë edhe një kishë.

Kryesuesi **Halim Halimi**, tha se duhet lënë Drejtorisë së Pronës të merret me këtë çështje dhe ta paraqesin në mbledhjen e Kuvendit.

Dardan Sejdiu, sa i përket pikave të rendit të ditës të KPF-së, theksoi se është Kryetari ai që i cakton pikat, ndërsa drejtorët e sjellin materialin që duhet për KPF, ndërsa sa i përket raportit të auditorit, ai iu është dërguar asamblistëve.

Çështja e riorganizimit të drejtorive të Komunës së Prishtinës është në procedurë.

Lidhur me çështjen e varrezave dhe lokacionit për kishën protestante, z. Çelaj tha se kërkesa është sjellë në Komunë, do ta shqyrtojmë çështjen e lokacionit dhe në mbledhjen e radhës do ta paraqesim si pikë, sepse Drejtoria e Financave dhe Pronës e propozon lokacionin.

Kryesuesi propozoi që të punohet sipas rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe mbledhjes urgjente;
2. Propozimbuxheti për vitin 2016 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2016-2018;
3. Propozimrregullorja për tatim në pronën e paluajtshme;
4. Propozimvendimi për miratimin - lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria";
5. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Mati 1";
6. Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes "Lakërishta" në Prishtinë;
7. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër;
8. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë;
9. Propozimrregullorja për rrugët lokale;
10. Caktimi i komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale;

11. Plotësimvendimi për anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
12. Caktimi i anëtarëve të grupit punues për plotësimin dhe hartimin e Rregullores për bashkësi lokale;
13. Shqyrtimi i peticionit të banorëve të lagjes "Prishtina e Re" lidhur me Planin urbanistik;
14. Propozimvendimi i Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës;
15. Të ndryshme.

Pika e parë

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së gjashtë dhe mbledhjes urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimbuxheti për vitin 2016 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2016-2018.

Sa i përket **Propozimbuxhetit për vitin 2016 dhe shqyrtimit të Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2016-2018**, Dardan Sejdiu tha se është punuare në përputhje me kërkesat ligjore.

Visar Berisha informoi lidhur me **Propozimbuxhetin për vitin 2016 dhe shqyrtimin e Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2016-2018**, duke thënë se buxheti i komunës së Prishtinës për vitin 2016 do të jetë 65,883,762 €, ndërsa planifikimi për të hyra vetjake do të jetë 30,000,000 €.

Sami Hamiti, sa i përket buxhetit të vitit 2016, tha se nuk ka vërejtje në aspektin ligjor në hartimin e tij, as në arsyetimin, por pati vërejtje në bartjen e mjeteve. Ai kërkoi që arkëtimi i të hyrave të shikohet dhe për Kuvend të jetë lista e projekteve të infrastrukturës.

Lirak Çelaj kërkoi të zbërthehen investimet kapitale dhe të specifikohen pikat tjera.

Sa i përket shpronësimit, duhet të ketë mjete më shumë, të jetë buxheti më i madh për shpronësim, po ashtu edhe te kultura duhet të ketë më shumë specifikime. Ai propozoi që në Kuvend të dalin me të dhëna më konkrete për fusha të ndryshme.

Hatixhe Hoxha tha se në të ardhmen është mirë që t'i bashkëngjitet edhe një aneks me tabela, marr parasysh edhe strukturën gjinore, pra për burra dhe gra për djem e vajza, përqindja për stafin e punësuar dhe për përfituesit e projekteve, bursave etj. sipas drejtorive, sepse kjo kërkohet në bazë të Ligjit për barazi gjinore. Edhe pse sa kuptova Ministria e Financave ua dërgon juve shabllon, kuptova se edhe komunat duhet ti bëjnë trusni Ministrisë së Financave për këtë çështje. Për këtë buxhet nuk mund të bëhet asgjë, mirëpo të punohet për vitin tjetër.

Laura Zherka parashtroi pyetjen se sa ka pasur të hyra vetjake deri në muajin qershor. Sa i përket planifikimit të projekteve, shumica e projekteve janë vazhdim i projekteve të mëhershme, nuk kemi projekte të reja madhore me filluar me projekte zbatuese.

Visar Berisha dha sqarime lidhur me pyetjet e parashtruara.

Sami Hamiti theksoi se projektet e mëdha nuk mund të realizohen pa bashkëfinancim.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah **Propozimbuxheti për vitin 2016 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2016-2018, që me vërejtjet e bëra t'i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

Pika e tretë

Propozimrregullorja për tatim në pronën e paluajtshme.

Visar Berisha dha sqarime lidhur me **Propozimrregulloren për tatim në pronën e paluajtshme.** Ai ceku se komuna e Prishtinës ndahet në dhjetë zona tatimore. Vlera e pronave përcaktohet sipas kategorive të pronës dhe zonave të vlerësimit dhe janë shprehur në € për 1 m².

Sami Hamiti u shpreh se në Kuvend i analizojmë dhe i diskutojmë këto çështje.

Lirak Çelaj tha se këto çështje duhet t'i analizojnë më detajisht, t'i dallojmë zonat sipas tatimit. Ai kërkoi, brenda mundësive, t'u sillet edhe rregullorja me tarifafat paraprake.

Qëndron Kastrati falënderoi drejtorin për punën e bërë dhe e përkrah punën e tij. Ai kërkoi që të merren parasysh zonat që kanë vlerë më të lartë.

Agim Salihu dha sqarime lidhur me këtë rregullore.

Visar Berisha tha se Zyra e Kuvendit ju dërgon rregulloren me tarifafat paraprake.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah **Propozimrregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme, me plotësime, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

Pika e katërt

Propozimvendimi për miratimin - lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria";

Dardan Sejdiu tha se është fjala për unazën që kalon përkrah lagjes "Kalabria". Kjo mund të rregullohet në dy mënyra: pa shkuar në diskutim publik dhe me diskutim publik. Ai përkrahu dërgimin në diskutim publik.

Sami Hamiti tha se ky plan është nisur më herët, andaj është mirë të shkojë në diskutim publikë.

Qëndron Kastrati e përkrahu dërgimin e Planit rregullues në diskutim publik.

Lirak Çelaj paraqiti qëndrimin e PDK-së, që të mos diskutohen pikat të cilat kanë të bëjnë me Drejtorinë e Urbanizmit.

Kryesuesi kërkoi që në të gjitha propozimvendimet e hartuara nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, tash e tutje në vend të Drejtorisë të shkruhet Sektori i planifikimit hapësinor i Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se, me vërejtjet e dhëna, njëzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin - lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Mati 1".

Sami Hamiti tha se sa i përket Propozimvendimit për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Mati 1", nuk është në harmoni me ligjin, andaj duhet të shqyrtohet dhe të shikohet për Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se, me shqyrtime dhe plotësime, njëzëri u përkrah që Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Mati 1", t'i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes "Lakërishta" në Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah që, me shqyrtimin nga drejtoria, Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes "Lakërishta" në Prishtinë, t'i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajjtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë.

Dardan Sejdiu dha sqarime lidhur me këtë propozimvendim.

Lirak Çelaj bëri të ditur se kanë kërkuare në Kuvend që për këtë çështje të zhvillohen diskutime me banorët e Barilevës. Banorët e kanë brengën për fushën e sportit, ata kanë menduar ta dërtojnë një qendër të sportit dhe të mbulohet një deponi në Barilevë.

Dardan Sejdiu dha sqarime, duke thënë se nuk ka mundësi për t'i dhënë premtime askujt.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e nëntë

Propozimrregullorja për rrugët lokale.

Sami Hamiti shprehu mendimin se kjo nuk i plotëson kushtet, andaj teksti duhet të përmirësohet nga drejtoria.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah që, me përmirësime nga drejtoria, Propozimrregullorja për rrugët lokale t'i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e dhjetë

Caktimi i komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale.

Kryesuesi tha se nuk ka material, por për Kuvend të gjenden emrat për komisionin për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah caktimi i komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e njëmbëdhjetë

Plotësimvendimi për anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Plotësimvendimi për anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e dymbëdhjetë

Caktimi i anëtarëve të grupit punues për plotësimin dhe hartimin e Rregullores për bashkësi lokale.

Kryesuesi theksoi se është fjala për caktimin e anëtarëve të grupit punues për plotësimin dhe hartimin e Rregullores për bashkësi lokale. Ai propozoi që të konsultohen me drejtorin e Drejtorisë së Administratës dhe të caktohen anëtarët e grupit punues.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah caktimi i anëtarëve të grupit punues për plotësimin dhe hartimin e Rregullores për bashkësi lokale dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e trembëdhjetë

Shqyrtimi i petitionit të banorëve të lagjes “Prishtina e Re” lidhur me Planin urbanistik.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah shqyrtimi i petitionit të banorëve të lagjes “Prishtina e Re” lidhur me Planin urbanistik dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e katërbëdhjetë

Propozimvendimi i Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës.

Dardan Sejdiu bëri të ditur se është një komision që është zgjedhur nga Kuvendi i Komunës, është komisioni që ka punuar.

Florina Rrahmani informoi lidhur me punën e komisionit. Ajo tha se Komisioni ka mbajtur 50 takime, ku propozimet që kanë ardhur nga Bashkësitë lokale, nga qytetarët dhe nga vetë komisioni, janë shqyrtuar dhe janë bërë emërtimet në bazë të kriterëve.

Lirak Çelaj tha se nuk është në listën e emërtimeve të rrugëve emri i Adem Demaçit dhe i Ukshin Hotit. Për Ukshin Hotin tha se kanë marrë vendim për caktimin e vendit.

Florina Rrahmani sqaroi, duke thënë se kur ka ardhur propozimi, komisioni e pati kryer punën, por kanë qenë duke punuar në listën rezervë, kështu që në listën rezervë është përfshirë emri i Adem Demaçit.

Qëndron Kastrati u shpreh i kënaqur me punën e komisionit. Ai tregoi interesim që t'i drejtohet komisionit, para se të shkojë në Kuvend propozimvendimi, për dy propozime, njëri ka të bëjë me shtimin e një rruge dhe tjetra për heqjen e një emërtimi.

Florina Rrahmani tha se nëse kanë qenë rrugë të vjetra, komisioni nuk ndërhy.

Mbledhja përfundoi në orën 17:40.

Procesmbajtës:
Zijadin Gashi dhe
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.